

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6703
E hënë, 12 shtator 2022
çmimi 0.40

LDK-ja: Kjo qeveri ka dështuar në shëndetësi

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GREVA VAZHDON, JASHTË SHKOLLAVE RRETH 300 MIJË NXËNËS

FAQE 4-5



Mësimdhënësit e të gjitha institucioneve publike janë në grevë. Ata, nëpërmjet SBASHK-ut, kërkojnë mbështetje financiare prej 100 eurosh në muaj. Greva ka lënë jashtë shkollave rreth 300 000 nxënës. Nuk ka asnjë datë të mundshme për fillimin e mësimin. Deri më tani as SBASHK-u dhe as qeveria

nuk janë pajtuar për të arritur deri të një zgjidhje. Ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka thënë të dielën se paralajmërimet e SBASHK-ut për kushtëzimin e dialogut të mëtutjeshëm, si dhe ato për moszëvendësimin e orëve të humbura, vetëm sa e ndërlikojnë situatën

AKTUALE



CHARLES III ZYRTARISHT SHPALLET MBRET F. 2

OSMANI MERR PJESË NË TAKIMIN E PRESIDENTËVE TË RAJONIT NË PROCESIN BËRDO-BRIONE NË SLLOVENI F. 3

GËRVALLA KËRKON PËRKRAHJEN E MALIT TË ZI NË PROCESIN EUROATLANTIKE F. 6

EKONOMI



MINISTRI I BUJQËSISË I BASHKËNGJITET VJELJES SË RRUSHIT F. 7

BIE QARKULLIMI FINANCIAR I BIZNESEVE SI RRJEDHOJË E NGECJES SË PROJEKTEVE KAPITALE F. 7

SPORT



PEJA TRIUMFON NË KLASIKEN NDAJ PRISHTINËS F. 10



KOSOVA BËN HOMAZHE NË PËRVJETORIN E 21-të TË SULMEVE TË 11 SHTATORIT NË SHBA F. 5



MANDL: SHTETET QË NUK E KANË NJOHUR KOSOVËN DUHET TA NDJEKIN SHEMBULLIN E IZRAELIT F. 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 487 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Charles III shpallet edhe zyrtarisht mbret



LONDËR, 11 SHTATOR - Charles III është shpallur të shtunën edhe zyrtarisht mbret i Mbretërisë së Bashkuar pas vdekjes së Mbretëreshës Elizabeta II më 8 shtator.

Ceremonia është mbajtur në Pallatin Shën James në Londër. “Jam krejtësisht i vetëdijshëm për këtë trashëgimi të madhe dhe për detyrat e përgjegjësitë e sovranitetit që janë tani mbi mua”, ka thënë mbreti Charles III gjatë ceremonisë.

Pas përfundimit të ceremonisë, në të cilën kanë marrë pjesë mbi 200 persona, lajmi për mbretin e ri i është kumtuar publikut nga ballkoni.

Më pas kanë luajtur trumbetat dhe është lëshuar himni kombëtar.

Flamujt, që kanë qenë në gjysmështrigë pas vdekjes së

Mbretëreshës Elizabeta II, janë ngritur sërish lart pas takimit të të ashtuquajturit Këshill i Aderimit.

Në një prej vendimeve të para mbreti ka vendosur që dita e varrosjes së Mbretëreshës Elizabeta II të jetë ditë pushimi në gjithë Mbretërinë e Bashkuar, ndonëse data e saktë nuk dihet ende.

Ky njoftim vjen pasi mbreti është zotuar se do ta ndjekë rrugën e “nënës së tij të dashur” për t’i shërbyer kombit.

Përgjatë fjalimit televiziv ai e ka kujtuar dashurinë dhe humorin e mirë të nënës së tij e cila ka qenë në fron për 70 vjet.

Charles është bërë mbret në momentin që i ka vdekur nëna mirëpo, sipas traditave, Këshilli i Aderimit mblidhet sa më shpejt që është e mundur për ta

shpallur pasardhësin.

Në këtë takim mbreti ka mbajtur një fjalim për vdekjen e mbretëreshës dhe më pas është betuar për ta mbrojtur Kishën e Skocisë - sepse në Skoci pushteti ndahet në mes të kishës dhe shtetit.

Në mesin e pjesëmarrësve kanë qenë Camilla, gruaja e Charlesit, dhe djali i tij William, princi i ri i Uellsit.

Arkivoli i Mbretëreshës Elizabeta II është bartur të dielën nëpër Skoci për t’i dhënë mundësi publikut që t’ia japë lamtumirën e fundit monarkes. Vdekja e 96 vjeçes është përcjellë me lot, hidhërim dhe kujtime të mira jo vetëm nga familja e ngushtë e mbretëreshës, por edhe shumë njerëz të tjerë në Britani dhe botë.

ShBA-ja i dërgon ndihma Pakistanit pas vërshimeve vdekjeprurëse

WASHINGTON, 11 SHTATOR - Pakistani ka pranuar ndihmë ndërkombëtare pas përballjes me vërshimet më të rënda ndonjëherë. Dy aeroplanë ushtarakë amerikanë - secili i ngarkuar me rreth 35 tonë ndihma - kanë arritur të dielën në provincën Sind, një prej zonave më të prekura nga vërshimet.

Pakistani ka regjistruar rënie ekstreme të shiut në mesin e muajit qershor.

Gati 1 400 njerëz kanë vdekur, mbi 13 000 janë plagosur dhe miliona të tjerë kanë mbetur pa strehë mbi kokë.

Ujërat kanë shkatërruar rrugët

dhe infrastrukturën për komunikime.

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, ka vizituar më 10 shtator disa zona të prekura nga vërshimet dhe ka bërë thirrje për më shumë mbështetje për këtë vend. “Sot është Pakistani, nesër mund të jetë shteti ku po jetoni. Kjo është krizë globale dhe kërkon përgjigje globale”, ka thënë Guterres në një konferencë për media.

Pakistani ka vlerësuar se dëmet kapin vlerën e 30 miliardë dollarëve.

Si qeveria, ashtu edhe Guterres, kanë thënë se ndryshimet

klimatike janë fajtoreshë për vërshimet.

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka paralajmëruar më 7 shtator për rrezikun e përhapjes së sëmundjeve. Valët e të nxehtëit dhe stuhitë janë bërë më intensive dhe më të shpeshta në vitet e fundit për shkak të ndryshimeve klimatike të nxitura nga njeriu.

Bota tashmë është ngrohur për 1.1 gradë celsius prej nisjes së epokës industriale, he temperaturat do të vazhdojnë të rriten në rast se qeveritë në botë nuk marrin hapa për t’i ndaluar emetimet e karbonit dhe gazrave të tjerë.



Britania hedh poshtë deklaratat e Putinit për eksportet e grurit ukrainas



LONDËR, 11 SHTATOR - Pretendimet e presidentit rus, Vladimir Putin, se vetëm një pjesë e grurit të eksportuar nga Ukraina është duke arritur në vendet e varfra, nuk janë të vërteta, ka thënë Ministria e Mbrojtjes e Britanisë.

Pa ofruar të dhëna, Putini ka thënë më 7 shtator se vetëm dy prej 87 anijeve me rreth 60 000 tonë të produkteve kanë shkuar në vendet e varfra.

Marrëveshja në mes të Rusisë dhe Ukrainës, për eksportimin e grurit nga portet ukrainase të Detit të Zi, është ndërmjetësuar javë më parë nga Kombet e

Bashkuara dhe Turqia.

Duke cituar të dhënat e OKB-së, ministria britanike ka thënë më 11 shtator se rreth 30 për qind e eksporteve të grurit janë dërguar në shtetet me të ardhura të mesme apo të ulëta në Afrikë, Lindje të Mesme dhe Azi.

Ministria britanike e ka akuzuar Rusinë për dezinformim të qëllimshëm për t’i ikur fajit që ka për situatë të pasigurt me ushqime në botë pas nisjes së luftës së Ukrainë.

Rusia dhe Ukraina janë të dyja furnizuese kyçe të drithërave dhe konflikti i vazhdueshëm

vetëm ka vënë në pah brishtësinë e zinxhirit global të furnizimit me ushqime kur dy shtetet kryesore janë jashtë tregut.

Më 2021 Rusia dhe Ukraina janë renditur si lidere globale në eksport të elbit, misrit, luleve të verdha për vajra, farave të lulediellit dhe vajit të lulediellit. Së bashku ato eksportojnë pothuajse 30 për qind të furnizimeve me grurë në botë. Rusia eksporton 17 për qind të grurit në nivel botëror, ndërsa Ukraina rreth 20 për qind të luleve të verdha për vajra.

Mandl: Shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën duhet ta ndjekin shembullin e Izraelit

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Deputeti i Parlamentit Evropian, Lukas Mandl, ka thënë se shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën duhet ta ndjekin shembullin e Izraelit. Mandl ka theksuar se njohja e Izraelit është një nga vendimet më të vlefshme gjeopolitike vitet e fundit.

“Vite më parë vizita në Ambasadën e Kosovës në Izrael do të ishte e paimagjinueshme sepse nuk kishte asnjë. Pastaj Izraeli e njohu Republikën e Kosovës me shumë urtësi dhe largpamësi. Në një botë plot konfuzion, ky ishte dhe është një nga vendimet më të

vlefshme gjeopolitike të viteve të fundit. Me kënaqësi kam biseduar me Ines Demirin në Ambasadën e Kosovës në Jerusalem për çështjet aktuale. Pakica e vogël e shteteve anëtare që ende nuk e njohin Kosovën duhet të ndjekin së shpejti Izraelin”, ka shkruar Mandl në “Facebook”.



Vuçiq: Perëndimi po propozon ‘kornizë të re’ për dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka bërë me dije se diplomatët evropianë kanë propozuar “kornizë të re” për dialogun në mes të Prishtinës dhe Beogradit që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian në Bruksel. Ai i ka bërë këto deklarata pas takimit që ka pasur me Këshillin e Sigurisë Kombëtare të Serbisë.

Dy ditë më herët Vuçiqi ka pritur në Beograd të dërguarin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, dhe këshilltarin e sapoemëruar të

Gjermanisë dhe të Francës për këtë dialog, Jens Plettner dhe Emmanuel Beaune. “Sipas tyre [diplomatëve evropianë], dialogu duhet të rezultojë me zgjidhje të menjëhershme dhe përfundimtare, siç thonë ata, të problemeve me të cilat po përballemi dhe të të gjitha çështjeve të pazgjidhura”, ka thënë Vuçiqi.

Ai ka shtuar se diplomatët evropianë kanë theksuar se e kanë edhe mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për diçka të tillë. “Marrëveshja do të nënkuptonte - nuk mund të them njohje të Kosovës -



mirëpo do të ishte njohje gjithçkaje që ata mendojnë se është realitet”, ka thënë Vuçiq. Sipas tij, përfaqësuesit evropianë kanë treguar se pozicioni i Perëndimit është se Evropa nuk ka nevojë për konflikte të reja, andaj është shumë e rëndësishme të gjendet një zgjidhje sa më shpejt që është e mundur. Vuçiqi ka thënë se në takim me diplomatët evropianë ka përsëritur se Serbia nuk do ta njohë Kosovën, por se është e gatshme për zgjidhje kompromisi. Ai nuk ka dhënë detaje se çfarë nënkupton me zgjidhje kompromisi.

IPK-ja suspendon tre zyrtarë policorë



PRISHTINË, 11 SHTATOR - Inspektorati Policor i Kosovës, respektivisht hetuesit e Departamentit të Hetimeve të IPK-së, i kanë rekomanduar Policisë së Kosovës suspendimin e tre zyrtarëve policorë në dy raste të ndryshme, një në Kllokot dhe një rast tjetër në Fushë-Kosovë.

“Informatat e para për rastin e Kllokotit IPK i ka pranuar përmes Linjës së Kaltër (numri i telefonit pa pagesë 080003333) lidhur me dyshimin se dy zyrtarë policorë janë të përfshirë si të dyshuar për veprën penale ‘keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar’. Një qytetar kishte raportuar në Linjën e Kaltër se këta dy zyrtarë

policorë nuk kanë ndërmarrë veprimet hetimore ndaj të dyshuarve pas ankesës së tij (duke mos përfshirë në deklaratën e tij kërcënimet që ai kishte pranuar nga një zyrtar i lartë i komunës së Kllokotit)”, ka njoftuar IPK-ja.

Pas verifikimit të informacioneve të pranuar nga ankesuesi, në konsultim me Prokurorinë Themelore në Gjilan, hetuesit e IPK-së janë duke zhvilluar hetime me dyshimin se dy zyrtarët policorë kanë kryer veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Me rekomandim të Inspektoratit Policor të Kosovës zyrtarët e përfshirë si të dyshuar në këtë

rast janë suspenduar.

Në rastin tjetër, Inspektorati Policor i Kosovës, respektivisht hetuesit e Departamentit të Hetimeve të IPK-së, i kanë rekomanduar Policisë së Kosovës suspendimin e një zyrtari policor me dyshimin për veprën penale të kanosjes.

Informatat e para për këtë rast IPK i ka pranuar mbrëmë dhe hetuesit kanë dalë në vendin e ngjarjes.

Hetuesit e IPK-së, në koordinim të plotë me Prokurorinë e Shtetit, do të vazhdojnë të ndërmarrin edhe veprime të tjera hetimore drejt ndriçimit të plotë të të gjitha rrethanave që ndërliken me dy rastet.

Osmani merr pjesë në takimin e presidentëve të rajonit në procesin Bërdo-Brione në Slloveni

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, krahas presidentëve të shteteve të rajonit, do të marrë pjesë në takimin e 11-të të procesit Bërdo-Brione.

Presidenca e Kosovës ka njoftuar se temat të cilat do të diskutohen në këtë takim përfshijnë perspektivën e integritimit evropian për vendet aspiruese të

Ballkanin Perëndimor, të cilat i përmbushin kushtet për integrim dhe të cilat i bashkërendojnë politikat me ato të Bashkimit Evropian për tejkalimin e sfidave të përbashkëta si pasojë e agresionit të paprovokuar të Rusisë në Ukrainë, përfshirë krizën energjetike dhe sigurinë ushqimore, si dhe përkushtimin për demokraci, paqe dhe dialog. Presidentja Osmani do t'i paraqesë qëndrimet e

Republikës së Kosovës lidhur me temat që do të trajtohen në këtë proces, përfshirë thirrjen për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës si dhe avancimin e rrugës euroatlantike të vendit tonë.

Takimi i Procesit Bërdo-Brione do të mbahet në Bërdo afër Kranjit në Slloveni nën udhëheqjen e presidentit të Sllovenisë, Borut Pahor dhe presidentit të Kroacisë, Zoran Milanović.





Greva vazhdon, jashtë shkollave rreth 300 mijë nxënës

Mësimdhënësit e të gjitha institucioneve publike janë në grevë. Ata, nëpërmjet SBASHK-ut, kërkojnë mbështetje financiare prej 100 eurosh në muaj. Greva ka lënë jashtë shkollave rreth 300 000 nxënës. Nuk ka asnjë datë të mundshme për fillimin e mësimin. Deri më tani as SBASHK-u dhe as qeveria nuk janë pajtuar për të arritur deri të një zgjidhje. Ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka thënë të dielën se paralajmërimet e SBASHK-ut për kushtëzimin e dialogut të mëtutjeshëm, si dhe ato për moszëvendësimin e orëve të humbura, vetëm sa e ndërlikojnë situatën

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Mësimdhënësit e të gjitha institucioneve publike janë në grevë. Ata, nëpërmjet SBASHK-ut, kërkojnë mbështetje financiare prej 100 eurosh në muaj. Përfshirë edhe mësimdhënësve individualë që kanë nisur t'i mbajnë orët. Greva ka lënë jashtë shkollave rreth 300 000 nxënës. Nuk ka asnjë datë të mundshme për fillimin e mësimin.

Deri më tani as SBASHK-u dhe as qeveria nuk janë pajtuar për të arritur deri të një zgjidhje.

Qeveria ka dalë me një propozim për t'ua ndarë nga 50 euro në muaj të gjithë të punësuarve në sektorin publik, përfshirë edhe mësimdhënësve, nga shtatori deri në fund të këtij viti, por me këtë propozim nuk

është pajtuar kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj.

Më 10 shtator kryeministri Albin Kurti dhe ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, kanë zhvilluar takim me kryetarin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Atdhe Hykolli. Për më shumë se një orë është diskutuar për grevën e shpallur nga BSPK-ja, për kërkesën sindikale për shtesën prej 100 eurosh dhe për veprimet e deritanishme të qeverisë për trajtimin e kërkesave të tjera paraprake të sindikatave.

Kryeministri Kurti e ka njoftuar Hykollin se Projektligji për Pagat e sektorit publik këtë javë ka përfunduar fazën e konsultimeve paraprake dhe se gjatë javës që po vjen do të dalë në konsultime publike. Ai e ka ftuar BSPK-në të bëhet pjesë e këtyre konsultimeve.

Më tej, Kurti ka thënë se qeveria

që drejtohet nga ai ka treguar gatishmëri për të adresuar kërkesa sindikale që trajtojnë në mënyrë sistematike problemet e punëtorëve të sektorit publik. Si dëshmi ka marrë vendimet e MASHTI-t për të ndarë 1.7 milion euro për 300 mësimdhënës me probleme shëndetësore, për buxhet shtesë për mësimdhënësit që kualifikohen si tepriçë ashtu që mos të mbesin pa punë, trajtimin e barabartë të mësuesve klasorë dhe lëndorë në arsimin e mesëm të ulët, eliminimin e padrejtësive ndërmjet të gjitha kategorive të punëtorëve të arsimit dhe renditjen e mësimdhënësve me koeficientin më të lartë ndonjëherë sipas projektligjit të ri.

Por edhe ky takim nuk ka sjell rezultat për ta ndërprerë grevën kjo sindikatë.

E pozicioni i drejtuesve të SBASHK-ut është se nuk fillon

mësimi para se të plotësohet kërkesa prej 100 eurosh.

Përfaqësues të SBASHK-ut kanë theksuar të dielën se greva vazhdon pasi, sipas tyre, qeveria nuk është e interesuar për dialog. Ata kanë thënë se orët e humbura nuk do të zëvendësohen.

Pas këtyre deklaratave të SBASHK-ut ka reaguar të dielën sërish ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci. Ajo në "Facebook" ka shkruar se është viti i tretë radhazi që java e dytë e shtatorit i gjen nxënësit në shtëpi. Nagavci ka theksuar se në dy vitet e kaluara kjo ndodhi për shkak të pandemisë, e cila çregulloi edhe procesin edukativo-arsimor, duke shkaktuar humbje të mëdha mësimore. Ndërkaq, sipas saj, këtë vit vonesa po ndodh për arsye që lehtësisht kanë mundur të shmangen e që kanë rezultuar me humbjen e rreth 580 mijë orëve të mësimin në 7 ditët e grevës së organizuar nga BSPK-ja dhe SBASHK-u. "Greva, në formë të ndërprerjes së plotë të punës dhe pa kufizim kohor, është hap ekstrem që ndërmerret vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe nuk ka kurrfarë arsyeshmërie në kushtet kur qeveria ka bërë disa

hapa dhe ka ndërmarrë vendime të dinjitetshme për adresimin e kërkesave të parashtruara nga sindikatat", ka thënë ajo.

Ministrja Nagavci ka deklaruar se paralajmërimet për kushtëzimin e dialogut të mëtutjeshëm, si dhe ato për moszëvendësimin e orëve të humbura, vetëm sa e ndërlikojnë situatën. "Me këtë rast, më duhet të rikujtoj se kalendarin shkollor e nxjerrë MASHTI e jo sindikatat, ndërsa të njëjtit duhet t'i përmbahen si mësimdhënësit, ashtu edhe nxënësit dhe prindërit. Si mnistre, punonjëse e arsimit dhe qytetare e këtij vendi kërkoj nga kryesia e SBASHK-ut që të reflektojë për situatën e krijuar dhe, bashkë me përfaqësuesit e degëve komunale, ta ftojë anëtarësinë e vet për t'iu kthyer punës, në mënyrë që të krijojmë atmosferë për vazhdimin e dialogut konstruktiv, që është parakusht për zgjidhjen e problemeve komplekse në sektorin e arsimit", është shprehur ajo, duke theksuar se arsimit, në radhë të parë, është çështje e përmbytjes dhe cilësisë, për të cilën e kemi obligim që të punojmë të gjithë bashkë dhe të sigurojmë të ardhme më të mirë për fëmijët tanë.

Kosova bën homazhe në përvjetorin e 21-të të sulmeve të 11 shtatorit në ShBA

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara kanë shënuar të dielën 21-vjetorin e sulmeve më të mëdha terroriste në tokën e tyre. Si pasojë e këtyre sulmeve kanë vdekur rreth 3 000 njerëz. Nëntëmbëdhjetë militantë, të lidhur me grupin terrorist Al-Kaida, kanë rrëmbyer katër aeroplanë dhe i kanë përplasur aeroplanët në Kullat Binjake në Nju-Jork, në Pentagon, pranë Uashingtonit dhe në një fushë në Pensilvani. Edhe në këtë përvjetor krerët shtetërorë të Kosovës kanë bërë homazhe te pllaka përkujtimore “Kosova kujton” në Prishtinë, e cila nderon viktimat e këtij sulmi. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se pas sulmit të 11 shtatorit populli i ShBA-së dhe ai i Kosovës kanë bashkuar forcat për ta luftuar terrorizmin. “I bashkohemi gjithë popullit amerikan për ta ndarë dhimbjen për më shumë se 3 000 jetë të humbura në një betejë e cila edhe një herë u dëshmuar se ishte

betejë vlerash. Më 11 shtator 2001 shtetasit amerikanë ishin nën një prej sulmeve terroriste më të tmerrshme në historinë e njerëzimit. Por, atë ditë nuk u sulmua vetëm Amerika, u sulmuam të gjithë ne që besojmë në po të njëjtat vlera. Në vlerat e lirisë dhe demokracisë”, ka thënë ajo. Ndërkaq kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se mizoria që tronditi botën nuk ishte goditje vetëm kundër popullit amerikan dhe ShBA-së, por edhe sulm brutal mbi vlerat e lirisë, demokracisë, mirëqenies, civilizimit dhe paqes globale. “Edhe sot, në 21-vjetorin e kujtimit të njëjës ndër ditët më të tmerrshme në historinë e botës, populli dhe shteti ynë, Republika e Kosovës, me mendje e zemër janë pranë dhimbjes së familjeve të viktimave, popullit mik amerikan dhe përkrah shpëtimtarit e aleatit tonë më të fuqishëm, Shteteve të Bashkuara të Amerikës”, ka thënë Konjufca.



Foto: Zyra e Kryeministrit të Kosovës



Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është deklaruar pas homazheve. “Populli i Kosovës qëndron pranë popullit amerikan. SHBA-ja ka dëshmuar edhe pas sulmeve të 11 shtatorit se është komb i njerëzve të lirë e të barabartë dhe se nuk bën kompromis me vlerat e tyre”, ka thënë Kurti. Zëvendësambasadorja e Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Alyson Grunder, ka falënderuar autoritetet e

Kosovës që janë solidarizuar në përkujtim të kësaj ngjarjeje. “Unë kam qenë në Nju-Jork në atë ditë të kobshme duke shërbyer në misionin e ShBA-së në Kombet e Bashkuara. Mund ta imagjinoni tronditjen që do ta përjetonte secili njeri ndaj një akti të tillë, që synonte të vriste sa më shumë njerëz të pafajshëm. Mirëpo në ditët në vazhdim ne kemi parë solidaritetet nga e tërë bota, përfshirë këtu edhe Kosovën”.

Në Pejë përurohet memoriali “Kujtim dhe miqësi” në nderim të viktimave të 11 shtatorit

Me intonimin e dy himneve, atë të Kosovës dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të dielën në Pejë është bërë inaugurimi i memorialit “Kujtim dhe miqësi” në nderim të viktimave të 11 shtatorit nga sulmet terroriste në ShBA. Inaugurimi i Memorialit të 11 shtatorit është bërë në rrugën “Mbreti Pirro” me pjesëmarrje të zyrtarëve nga Ambasada Amerikane, zyrtarëve qeveritarë dhe rotarianëve

nga Shqipëria e Kosova. Memoriali përfshin një pjesë autentike të çelikut nga Kullat Binjake të Nju-Jorkut. “Ngritja dhe zbulimi i Memorialit të 11 shtatorit në Pejë e dëshmon edhe një herë krenarinë e madhe për miqësinë me ShBA-në si dhe nderon më shumë se 3 000 jetë të humbura nga tragjedia që goditi botën 21 vjet më parë!”, ka thënë kryetari i komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri.

LDK-ja: Kjo qeveri ka dështuar në shëndetësi

Anëtari i kryesisë i LDK-së, Ekrem Hyseni, ka thënë se ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, duhet të japë përgjegjësi për dështimet në shëndetësi. Sipas tij, në kohën e kësaj qeverie, përkatësisht në periudhën janar-maj 2022, mbi 520 qytetarë kanë kërkuar shërim jashtë vendit

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka mbajtur të dielën konferencë për medie, në të cilën ka shprehur shqetësimin për paaftësinë e Ministrisë së Shëndetësisë. Me këtë rast, anëtari i kryesisë i LDK-së, Ekrem Hyseni, ka thënë se ministri Rifat Latifi duhet të japë përgjegjësi për këto dështime. "Paaftësia e kësaj qeverie është duke dëmtuar seriozisht shëndetin e qytetarëve.

Paaftësia qeverisëse po i lë qytetarët pa shërbime shëndetësore. Profesionistët shëndetësorë po i trajton me lëmoshë, gjersa investimet kapitale në këtë fushë janë realizuar vetëm 5%. Është kjo qeveri që profesionistët shëndetësorë vazhdon t'i trajtojë me lëmoshë, gjersa vetëm për pak kohë mbi 120 profesionistë shëndetësorë kanë lënë vendin, ndër ta edhe 40 specializantë. Është kjo qeveri që javë më parë nuk ua vazhdoi kontratat mbi 1 000 pjesëtarëve të stafit mbështetës në luftën kundër pandemisë", ka thënë Hyseni. Ai ka theksuar se në kohën e kësaj qeverie, përkatësisht në periudhën janar - maj 2022, mbi 520 qytetarë tanë kanë kërkuar shërim jashtë vendit. "Në kohën e kësaj qeverie në



QKUK janë vetëm 48 anesteziologë të cilët duhet të shërbejnë për 44 njësi. Pra as dy sosh për njësi operuese. Në kohën e kësaj qeverie janë stërzgatur listat e pritjes së qytetarëve për të marrë shërbime shëndetësore, duke mbërritur deri në mesin e vitit 2023. Në kohën e kësaj qeverie mungesa e barnave në listën esenciale tashmë është bërë e zakonshme, me theks të veçantë shumë prej ilaçeve për sëmundjet malinje të cilat janë të domosdoshme për mjekimin e kësaj sëmundjeje të rëndë. Në kohën e kësaj qeverie është ulur buxheti për Ministrinë e Shëndetësisë për

rreth 60 milionë euro", ka thënë anëtari i kryesisë së LDK-së, Ekrem Hyseni.

Ai ka shtuar se në Ministrinë e Shëndetësisë, nga 15 projekte kapitale, kanë nisur vetëm dy prej tyre në vlera minimale. Në këtë ministri, sipas Hysenit, gjatë këtyre gjashtë muajve janë shpenzuar vetëm 5% nga buxheti për investime kapitale, më saktësisht nga 10 063 000 euro janë shpenzuar vetëm 530 702 euro. "Në kohën e kësaj qeverie dominojnë arroganca, mosveprimi, propaganda, jodëgjueshmëria profesionale, tipare këto të qeverisjeve të paafta dhe populiste, ndaj dhe kjo qeveri nuk bën përjashtim

me sjelljen e saj. Në kohën e kësaj qeverie, përkundër të gjithave e gjithçkaje, ne si parti opozitare kemi ofruar Ligjin për Shëndetësinë në mënyrë që t'u dalim në mbrojtje qytetarëve dhe profesionistëve shëndetësorë, ndërsa si kundërpërgjigje kemi marrë padëgjueshmërinë. Kjo qeveri e përjashton një ligj të gatshëm vetëm se e ka ofruar opozita, duke humbur kështu kohë për më shumë se një vit. Këto janë vetëm disa nga dështimet e fundit të kësaj qeverie që e bëjnë epilogun e tmerrshëm në fushën e shëndetësisë, ku burim parësor definitivisht e ka paaftësinë", ka thënë Hyseni,

duke shtuar se kohë më parë ministri i Shëndetësisë ka deklaruar se në rast dështimi, ai kthehet nga ka ardhur. "Së pari është e frikshme se si vetëm ai dhe qeveria e tij nuk po e sheh dështimin e thellë edhe në shëndetësi. Së dyti, nëse këta që kanë dështuar vendosin edhe ta pranojnë dështimin, i bie që ministri në fjalë mjaftohet me ikje nga vendi. Kësaj qeverie edhe sot i bëjmë thirrje dhe i themi që: provo për të dëgjuar, provo për të mësuar dhe në fund për të punuar, ndryshe do të mbetesh vula e dështimit dhe dëmtimit të shëndetit të krejt qytetarëve të vendit", ka deklaruar Hyseni.

Gërvalla kërkon përkrahjen e Malit të Zi në proceset euroatlantike

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Zëvendëskryeminstri, njëherësh ministri i Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Republikës së Kosovës, Donika Gërvalla-Schwarz, ka pritur në takim zëvendëskryeminstri të Republikës së Malit të Zi, Rashko Konjeviq, që është edhe ministër i Mbrojtjes në këtë shtet fqinj të Kosovës.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla-Schwarz, e ka njoftuar ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Malit të Zi, Rashko Konjeviq, rreth aspiratave euroatlantike të Republikës së Kosovës dhe ka kërkuar ndihmën e Malit të Zi lidhur me aplikimin e Republikës së Kosovës në programin "Partneriteti për Paqe" (PfP) dhe Kartën e Adriatikut.

Ministria Gërvalla-Schwarz në takim ka theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së Republikës së Kosovës në të gjitha



bashkëpunimet rajonale që ndërliken me siguri. Ajo e ka falënderuar zëvendëskryemin-

istrin, njëherësh ministrin e Mbrojtjes të Malit të Zi, Rashko Konjeviq, për bashkëpunimin

me Republikën e Kosovës që, sipas saj, ka ndikim të shumanshëm në të mirën e

sigurisë, stabilitetit dhe demokracisë mes dy vendeve mike.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla-Schwarz, po ashtu e ka njoftuar ministrin Konjeviq për bisedimet në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Në kontekstin e situatës së sigurisë në rajon edhe më tej ministria Gërvalla-Schwarz ka theksuar se duhet vëzhguar me kujdes ndikimi i agresionit rus në Ukrainë të shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe homologu nga Mali i Zi, Rashko Konjeviq, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi në nivel të dy ministrive të mbrojtjes. Me nënshkrimin e këtij memorandum të bashkëpunimit, dëshmohet vazhdimësia e bashkëpunimit në mes të dy vendeve, në nivele të tjera, me aktivitete dhe angazhime të përbashkëta.

Ministri i Bujqësisë i bashkëngjitet vjeljes së rrushit

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, i është bashkëngjitur të dielën vjeljes së rrushit. "Teki Cena është një ndër shembujt e vreshtarit të vyer të cilit natyra ia ka shpërblyer mundin, me frutet e punës që volëm sot", ka shkruar ministri në "Facebook".

Ai ka thënë se si Ministri e Bujqësisë shumë punë kanë

realizuar këtë vit e, sipas tij, edhe më shumë punë e presin këtë ministri. "Gjithmonë duke pasur prioritet bujkun, përmes avancimit të politikave të duhura dhe mbështetjes konkrete financiare, qoftë përmes subvencioneve ashtu edhe përmes granteve", ka shkruar ministri Peci.

Ai ka theksuar se kanë rritur përkrahjen me subvencione

dhe grante dhe javën që lamë pasë, duke hartuar edhe miratuar U.A. nr. 06.2022 të MBPZhR-së për Verifikimin e Produkteve Bujqësore dhe Artikujve Ushqimorë nga Trupat Certifikuese. "Një akt juridik tejet i rëndësishëm për sektorin e vreshtarisë dhe verëtarisë që lehtëson procesin e eksporteve të produkteve tona", ka thënë Peci.



Bie qarkullimi financiar i bizneseve si rrjedhojë e ngecjes së projekteve kapitale

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Bizneset po e përjetojnë periudhën më të vështirë këtë vit pasi qarkullimi financiar i tyre është dukshëm më i ulët se ai i vitit të kaluar.

Qarkullimi financiar ka rënë në masë të madhe sivjet si rrjedhojë e ngecjes në realizimin e projekteve kapitale nga institucionet qendrore dhe lokale, por edhe për shkak të rënies së nivelit të konsumit si pasojë e rritjes enorme të çmimeve për gati të gjitha produktet e importuara dhe vendore, raporton kp.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, shpreh shqetësimin e bizneseve për rënie të qarkullimit financiar, duke thënë se këtë vit Kosova ka realizuar pak investime kapitale, vetëm rreth 10 për qind.

Rafuna ka deklaruar se është e domosdoshme që të zhblokohen investimet kapitale në mënyrë që këto pastaj të kenë efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit. "Ka rënie të qarkullimit financiar. E mora shembull importin, tregtinë me mallra, ku kemi rënie të sasisë së mallrave, por edhe në brendi, në bazë të kontakteve dhe takimeve ditore që kam me bizneset, kanë shprehur shqetësimin që konsumi i këtij viti nuk është i njëjti me vitin e kaluar. Ka shumë më pak qarkullim sesa vitin e kaluar", thekson ai.

Ai ka mirëpritur paralajmërimin e kryeministrit Kurti për procedim në qeveri të Projektligjit për Punë Publike që parasheh kompensimin e inflacionit për materialet ndërtimore dhe punët



përcjellëse për kontratat ekzistuese. "Pa dyshim se po, në rast se stimulohet, për arsye se neve na kanë përcjellë edhe disa situata jo të mira siç ishte rasti me OShP-në (Organin Shqyrtues të Prokurimit), sa ishte i bllokuar tërësisht ky organ, dhe procedurat ose ofertat që janë bërë në muajin mars e prill, tani ai çmim nuk qëndron më, për arsye se është rritur 200 ose 300 për qind. Për këtë arsye rasti më i mirë është Shqipëria ose dhe vendet e tjera, ku qeveria ka negociuar me bizneset për t'i kompensuar pjesën e çmimit të rritur për bizneset të cilat kanë aplikuar

për projekte të ndryshme dhe kështu kanë vazhduar projektet dhe kanë vazhduar investimet kapitale. Ne jemi dëshmitarë që Kosova sivjet ka shumë pak investime kapitale, kështu që ne duhet ta gjejmë rrugën në mënyrë që sa më shumë të investojmë në investime kapitale që do të kenë efekt të drejtpërdrejtë në zhvillim ekonomik, por edhe në rritje të bizneseve tona. Prandaj, padyshim që është i mirëseardhur", thotë ai.

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se ishte e domosdoshme që qeveria të

hartojë Projektligjin për Punë Publike për ta përsheptuar dinamikën e zbatimit të investimeve kapitale. "Ky projektligj parasheh që për pjesën e dytë të këtij viti, të mundësohet dinamikë më e përsheptuar e investimeve kapitale asisoj që të gjitha punët publike, kontratat e mesme dhe të mëdha të lidhura sipas Ligjit për Prokurim Publik, të mund të mbështeten me kompensim për çmimet e rritura. Ka pasur çmime të rritura për materialet ndërtimore dhe kështu që ka pasur një hezitim nga ana e bizneseve që në pjesën e parë

të vitit t'i kryejnë punët meqenëse kontratat e lidhura kohë më parë kanë pasur çmime më të ulëta, kurse tani çmimi i furnizimit për ta është më i lartë dhe e kanë pasur të pamundur t'i kryejnë këto punë", ka thënë Murati.

Sipas një publikimi të Institutit GAP, rritja e çmimeve të materialeve ndërtimore dhe politikave qeveritare kanë bërë që realizimi i investimeve kapitale në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2022 të jetë më i ulët në dekadën e fundit. Në nivelin qendror janë realizuar vetëm 9 për qind e investimeve, ndërsa në atë lokal 19 për qind.

Milionat e humbura në Trust, Nitaj: Sikur qeveria t'ua kishte lejuar tërheqjen qytetarëve, kjo humbje do të përgjysmohej

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Sekretari i përgjithshëm i AAK-së, Muharrem Nitaj, thotë se humbjet e mëdha të Trustit llogariten dyfish pasi një pjesë të atyre mjeteve s'ishte lejuar që t'i tërhiqnin qytetarët.

Nitaj ka shkruar në "Facebook" se sikur qeveria ta kishte lejuar tërheqjen e 30 % për qytetarët, kjo humbje do të ishte për rreth 50 milionë më e vogël. "Trusti Pensional i paska humbur 161.6 milionë.

Sikur qeveria ta kishte lejuar tërheqjen e 30 % për qytetarët, kjo humbje do të ishte për rreth 50 milionë më e vogël. Që humbin askush s'jep llogari, kryesorja qytetarëve të mos u jepen", ka shkruar Nitaj.



Në kuzhinën time letrare ideale banon një luftëtar, të cilin disa zëra e thërrasin shkrimtar



Nga: Roberto BOLANO
Përktheu: Bajram Karabolli

Shpesh kuzhina ime letrare është një dhomë e zbrazët, ku nuk ka as dritare. Sigurisht mua do të më pëlqente që ajo të kishte diçka: një llambë, disa libra, një aromë të lehtë guximi; ama e vërteta është se nuk ka asgjë.

Megjithatë, nganjëherë, kur jam viktimë e sulmeve të pafrenueshme të optimizmit (që nga ana tjetër përfundojnë në hare të frikshme), kuzhina ime letrare kthehet në një kështjellë mesjetare (me kuzhinë) a në një apartament në Nju-Jork (me kuzhinë dhe pamje të privilegjuar) ose në një kasolle në shpatet e Kordilievave (pa kuzhinë, por me një vatër zjarri). Në ato çaste, i përqendruar, përgjithësisht bëj atë që bën çdo njeri: humbas ekuilibrin dhe mendoj se jam i pavdekshëm. Nuk dua të them i pavdekshëm, në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale, sepse këtë mund ta mendoj vetëm një budalla

dhe në atë pikë nuk arrij, por i pavdekshëm letrarisht, si qentë, fëmijët apo qytetarët e mirë, të cilët ende s'janë të sëmurë. Për fat të mirë apo të keq, çdo sulm optimizmi ka një fillim dhe një fund. Nëse nuk do të kishte fund, sulmi i optimizmit do të kthehej në synim politik. Ose në mesazh religjioz. Dhe, prej aty, deri te varrosja e librave (nuk dua të them "djegia", sepse do të ishte tepërt) na ndanë veç një hap. E vërteta është se, të paktën në rastin tim, sulmet e optimizmit mbarojnë dhe me to mbaron edhe kuzhina letrare, ajo davaritet në ajër dhe mbetem vetëm unë, që sapo e kam marrë veten, por edhe një aromë tejet e lehtë kusish të pista, pjatash të latërzhjera, salcash të prishura.

Nganjëherë them me vete se kuzhina letrare është një çështje shijeje, domethënë është një fushë ku kujtesa dhe etika (ose morali, nëse më lejohet të përdor këtë fjalë) luajnë një lojë, rregullat e së cilës nuk i njoh. Talenti dhe epërsia, të përhumur, kundrojnë këtë lojë, pa marrë pjesë në të. Vetëm

guximi dhe trimëria futen në lojë, por edhe ato në çaste të llogaritura, të përpikta, madje vlen të thuhet se edhe ato nuk e tejkalojnë masën në pjesëmarrje. Vuajtja, dhimbja, vdekja, këto po, marrin pjesë, veç me kushtin që të luajnë duke qeshur. Le ta quajmë si një detaj të pashmangshëm kortezie.

Biblioteka letrare është shumë më e rëndësishme se kuzhina letrare. Një bibliotekë është shumë më komode se një kuzhinë. Nëse një bibliotekë ngjan me një kishë, një kuzhinë çdo ditë ngjan më shumë me një morg. Poeti spanjoll, Gil de Biedma ka thënë: "Të lexosh është më e natyrshme se të shkruash". Mbase e teproj dhe le të thonë ç'të duan oftalmologët, por unë do të shtoja se është edhe shumë më e shëndetshme. Në të vërtetë, letërsia është një luftë e gjatë, nga tepëria në tepëri, deri në teprinë e fundit.

Nëse do të më duhej të zgjidhja një kuzhinë letrare për të ndenjur atje gjatë një jave, do të zgjidhja atë të një shkrimtareje, veç jo të një shkrimtareje kiliane. Do të

jetoja me shumë kënaqësi në kuzhinën letrare të Silvina Okampos, në atë të Alejandra Pisarnikut, në atë të shkrimtares dhe poetes meksikane Carmen Bulosa (Carmen Boulosa), apo në atë të Simone de Bovuar. Midis arsyeve të shumta, edhe për atë se janë kuzhina shumë të pastra.

Ka plot net që e shoh në ëndërr kuzhinën time letrare: është tejet e madhe, sa tre stadione futboll, me çati të hakruara dhe tryeza të pambarimta, ku janë mbledhur gjithë qeniet e gjalla të tokës, ato që janë duke dhënë shpirt dhe ato që për pak kohë do të shuhen; një kuzhinë e ndriçuar në formë heterodokse, në disa zona me projektorë antiajror dhe në disa të tjera me pishtarë, dhe, sigurisht, nuk mungojnë edhe zona të errëta, ku mezi shquhen kaloj nëpër kuzhinën time letrare ku, nganjëherë, ndez një zjarr dhe pjek një vezë

apo thek një fetë buke. Pastaj zgjohem me një ndjesi të jashtëzakonshme lodhjeje.

Dhe, së fundi, një gjë mbetet e qartë: të mos kopjosh askënd. Të paktën, mos të të varën në sheshin publik. Megjithëse plagjiatorët, sot e kësaj dite, nuk i var kush. Përkundrazi, marrin bursa, çmime, detyra publike, dhe, në më të mirin e rasteve, bëhen best-sellers dhe liderë mendimi. Ç'fund i çuditshëm dhe i shëmtuar: lider mendimi. Që do të thotë bari kopeje ose udhëheqës shpirtëror i sklevërve, poet kombëtar ose babai i kombit, nëna e atdheut ose xhaxhai politik i atdheut.

Në kuzhinën time letrare ideale banon një luftëtar, të cilin disa zëra (zëra që s'kanë as trup e as hije) e thërrasin shkrimtar. Ky luftëtar përherë është duke luftuar dhe e di se në fund, sido që të vijë puna, do të mposhtet.

Megjithatë, vrapon nëpër kuzhinën letrare, që është prej çimentoje, dhe përballet me kundërshtarin e vet, pa i dhënë dhe pa i kërkuar mëshirë./Telegrafi

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Muriqi shënon gol në 'Santiago Bernabeu'

MADRID, 11 SHTATOR - Futbollisti i Përfaqësues së Kosovës, Vedat Muriqi ka gjetur sërish golin në La Liga. Kësaj radhe sulmuesi i Mallorcas ka shënuar në

"Santiago Bernabeu" në duel me Real Madridin, në kuadër të javës së 5-të në La Liga. Muriqi shënoi gol të bukur me kokë në minutën e 35-të, duke e

kaluar skuadrën e tij në epërsi. Megjithatë, më pas madrilenët e përmbysën rezultatin, duke festuar 4:1, me golat e shënuar nga Valverde (45'+3'), Vinicius

Jr (72'), Rodrygo (89') dhe Ruediger (90'+3'). Muriqi u zëvendësua në minutën e 79-të, derisa goli në 'Bernabeu' ishte i treti për të në këtë edicion.



Peja triumfon në klasiken ndaj Prishtinës

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Peja ka shënuar fitore ndaj Sigal Prishtinës në udhëtim me rezultat 70:76 (19:17, 11:23, 22:9, 18:27), në xhiron e parë të Prince Caffè Superligës. Fillimi i ndeshjes ishte i barabartë, ku gjatë çerekut të parë rezultati ishte i ngushtë, pasi asnjëra nga skuadrat nuk arrinte shkëputjen dhe kjo pjesë përfundoi 19:17. Megjithatë, periudha e dytë 'foli' në të mirë të mysafirëve, që dalëngadalë shkëputen, për të krijuar epërsi deri në 13 pikë, 23:36, kurse pjesa e parë përfundon 30:40. Në periodën e tretë,

prishtinasit rikthehen furishëm, duke aplikuar mbrojtje të suksesshme dhe sulme efikase, duke arritur të shkrijnë epërsinë e mysafirëve, madje edhe të kalojnë në epërsi, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 52:49, në një atmosferë 'elektrizuese' në kryeqytet. Vendasit vazhduan me lojë të mirë në çerekun e fundit, duke ngritur epërsinë në tetë pikë, 61:53, por verdhezinjtë nuk u dorëzuan dhe dy minuta nga fundi barazuan rezultatin në 67:67, e më pas kaluan në epërsi 67:70, për të bërë sfidën

shumë dramatike. Kështu edhe ndodhi ku fituesi u përcaktua në sekondat e fundit, duke përfunduar me rezultat 70:76. Te Prishtina u dallua Dardan Berisha me 25 pikë, tetë kërcime e gjashtë asistime, kurse te Peja, më i dalluari ishte Jalen Tate me 14 pikë dhe Rodney Purvis me 17. Bashkimi ka shënuar fitoren e parë në këtë edicion, duke mundur Vëllaznimin me rezultat 71:60 (18:10, 23:19, 16:13, 14:18), në xhiron e parë. Rahoveci ka shënuar fitore ndaj Golden Eagle Yllit me rezultat 90:88 (25:30, 25:17, 23:24, 17:17).



Drita fiton derbin ndaj Ballkanit, Prishtina merr një pikë në Gjilan

DRENAS, 11 SHTATOR - Drita ka shënuar fitore në kryendeshjen e javës së javës së 6-të në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll, duke e mundur kampionin në fuqi, Ballkanin. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas është mbyllur me rezultat 2-0, në dobi të mysafirëve. Ballkani e nisi ndeshjen pa disa prej futbollistëve titullarë, për shkak të ngarkesës së madhe në ndeshjet e Ligës së Konferencës dhe këtë e shfrytëzoi Drita, e cila e mbizotëroi lojën. Golat për gjilanasit i shënuan Marko Simonovski, në minutën e 31-të dhe Besnik Krasniqi, në



minutën e 59-të nga penalltia. Ndërkohë, Prishtina arriti të shkëpusë një pikë si mysafirë në Gjilan, duke barazuar 1-1. Të parët në epërsi kaluan futbollistët e Gjilanit, me golin e Elton Cale, në minutën e 40-të, derisa një

pikë për bardhekaltrit e kryeqytetit e siguroi Kreshnik Uka, nga penalltia, në minutën e 67-të. E fitoren e parë në këtë edicion e ka siguruar Ferizaj, që para tifozëve të vet e ka mposhtur Llapin, me rezultat 2-1. Golat

për ferizajasit i shënuan Astrit Fazliu, nga penalltia, në minutën e 29-të dhe Ramush Ramadani, në minutën e 42-të, teksa golin e vetëm për lllapjanët e realizoi Ilir Krasniqi, në minutën e 73-të. Trepça '89 ka shënuar fitoren e parë pas rikthimit në elitë. Skuadra e drejtuar nga Shpëtim Idrizi në të gjitha ndeshjet e deritashme kishte treguar lojëra të mira, por nuk kishte arritur t'i marrë pikët e plota në asnjërën prej tyre. Megjithatë, të shtunën, në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj, në kuadër të javës së 6-të "minatorët" arritën të shënojnë fitore në duel me Drenicën, me rezultat bindës 5-2. Protagonisti kryesor i

skuadrës mitrovicase ishte sulmuesi Christian Mba, i cili përveç se shënoi dy gola (28', 90'), asistoi edhe në golat e Bleon Sekiraqës (24') dhe Erdin Dushit (52'), teksa në listën e realizatorëve në fund u regjistrua edhe Armend Gashi (90'+). Në anën tjetër të dy golat për Drenicën i shënoi Bintsouka Koxy (30' e 50'). Në ndeshjen tjetër të ditës së sotme, Malisheva dhe Dukagjini kanë barazuar me shifrat 1-1, në stadiumin "Liman Gegaj" në Malishevë. Të parët shënuan vendasit me golin e Alban Shillovës, në minutën e 24-t, por një pikë skuadrës nga Klina ia siguroi Blerind Morina, me golin e realizuar në minutën e 77-të.

Verstaspeni triumfon edhe në Monza

Monza, 11 shtator - Max Verstaspen me Red Bull fitoi sot garën e Çmimit të Madh të Italisë në Formula 1, zhvilluar në pistën e Monza. Ky është suksesi i 11-të sezonal për pilotin holandez, i pesti radhazi. Kjo garë u mbyll nën regjimin e makinës së

sigurisë, e cila hyri në pistë pesë xhiro nga fundi, pas aksidentit të Daniel Ricciardo. Pista nuk u bë gati dhe në finish mbërriti e para makina e sigurisë e pas saj të gjithë pilotët. Verstaspen edhe pse e nisi garën nga vendi i shtatë, ai arriti të rikuperojë në pistë,

ndërkohë që përfitoi edhe nga një strategji ndryshe e Ferrari me Charles Leclerc. Në podium u ngjit edhe britaniku i Mercedes, George Russell, duke lënë pas Carlos Sainz (Ferrari), Lewis Hamilton (Mercedes) e Sergio Perez (Red Bull).





Republika e Kosovës Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref. AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ri shpall këtë:

KONKURS PËR PUNËSIM PËR KOHË TË CAKTUAR

I. Menaxher i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave një (1) pozitë, për dy (2) vite

Referenca:	KPK/ZKPSH/ZMNV/POZ- 018
Emri pozitës:	Menaxher i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
Pozita:	Pozitë jo e karrierës
Niveli:	Drejtues
Kodi punës:	DR/1070
Raporton tek:	Kryeprokurori i Shtetit, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së
Numri i pozitave:	Një (1) pozitë
Koeficienti:	Pesëmbëdhjetë (15)
Akti i emërimit:	Me afat të caktuar
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, mbikëqyrja, koordinimi dhe menaxhimi i punës së gjithmbarshme të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, duke përcaktuar politikën, standardet dhe veprimet në përputhje me legjislacionin përkatës. Harton programe, projekte, strategji dhe kujdeset për implementimin e tyre në mënyrë aktive, menaxhon me mjetet buxhetore dhe donacionet e ndryshme të siguruar për ZMNV. Koordinon punën në nivel të institucionit të prokurorit të shtetit dhe me partnerët e jashtëm dhe ndërkombëtar.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Menaxhon me punën e gjithmbarshme të zyrës së ZMNV-ës dhe personelin e sajë, përfaqëson zyrën brenda institucionit të PSH dhe para institucioneve tjera në vend dhe jashtë vendit; Koordinon punën me vartësit e vet lidhur me zbatimin e objektivave të punës, mbështetur në strategjinë, planet dhe ligjin; Kujdeset për hartimin dhe implementimin e politikave për ZMNV, duke harmonizuar procedurat e brendshme në përputhje me ligjet e aplikueshme; Përgjegjës për sigurimin e hapësirave dhe kushteve për punë të punësuarve në bashkëpunim me strukturën organizative dhe zyrat e institucionit të PSH-së; Merr pjesë në organizimin e programeve të ndryshme që kanë të bëjnë me mandatin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave; Këshillon stafin e ZMNV-ës, lidhur me zbatimin e procedurave dhe projekteve që kanë të bëjnë me Zyrarët për Mbrojtje të Viktimave; Raporton në periudha të përcaktuara në nivel të institucionit të PSH-ës, mbi punën dhe të arriturat e ZMNV-ës; Ndërmerr të gjitha veprimet ligjore ndaj personelit të ZMNV-ës, në të gjitha nivelet për zbatimin e politikave dhe përgjegjësi të secilit të punësuar dhe është përgjegjës për të njëjtit.

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Aftësi të larta komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim; Qasje fleksibile ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës së Zyrës për zgjidhjen e problemeve profesionale dhe organizative të rëndësishme për institucionin; Njohuri të thella dhe të specializuara për kryerje e punëve të MV; Njohuri të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj); Shkathtësi komunikuese me sjellje korrekte të besueshme dhe konfidenciale; Shkathtësi për hartim të akteve dhe shkresave dhe komunikim; Shkathtësi për të caktuar prioritetet e shqyrtimit të rasteve që ndërliken me punën e MV.; Të jetë i trajnuar në fushën e MV; Gatishmëri të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme; Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me të; Aftësia për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion; Aftësi të përgjithshme për raportim të rezultateve të arritura të punës si MV, Reagimi duhur në zgjidhjen e problemeve.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik.

Përvoja e Punës:

Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale.

Katër (4) vite përvojë pune në vende udhëheqëse.

- Konkursi është i hapur 8 ditë kalendrike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data 12.09.2022 deri me datë 19.09.2022 si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vullën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
- Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
- „Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.“
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:
- Dëshminë e kualifikimit shkollor;
- Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi dhe kontrata e punës (Letër Referenca apo Rekomandimi nuk pranohet si dëshmi mbi përvojën e punës);
- Dy rekomandime (nëse keni);
- Kopjet e dy raportëve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
- Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.
- Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Na osnovu člana 31 Zakona Br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova i člana 18 Pravilnika Br. 02/2010 o Procedurama Regrutovanja u Civilnoj Službi Kosova, na osnovu Presude br. Ref AGJ.1583/20 od 9 jula 2020 godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, ponovno objavljuje:

KONKURS ZA ZAPOSŁJAVANJE NA ODREĐENO VREME

I. Rukovodilac Kancelarije za Zaštitu i Pomoć Žrtvama

Kancelarije za Zaštitu i Pomoć Žrtvama jedna (1) pozicija, dve (2) godine

Referenca:	KPK/ZKPSH/ZMNV/POZ- 018
Naziv radnog mesta:	Rukovodilac Kancelarije za Zaštitu i Pomoć Žrtvama
Pozicija: pozicija	Pozicija ne karijere
Nivo:	Rukovodeći
Šifra posla:	DR/1070
Izveštava:	Glavnom Državnom Tužiocu, Generalnom Direktoru Sekretarijata TSK
Broj pozicija:	Jedna (1) pozicija
Koeficientat:	Petnaest (15)
Akt o imenovanju:	Na određeno vreme
Mesto:	Priština

Namena radnog mesta:

Rukovodjenje, nadzor, koordinacija i upravljanje celokupnog rada Kancelarije za Zaštitu i Pomoć Žrtvama, definirajući politike, standarde delovanja u skladu sa relevantnim zakonodavstvom. Ozradi programe, projekte, strategije i aktivno se brine o njihovoj implementaciji, upravlja budžetskim sredstvima i raznim donacijama predviđenim za KZPŽ. Koordinira rad na nivou institucije Državnog Tužioca i sa spoljnim i međunarodnim partnerima.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Rukovodi celokupnim radom kancelarije KZPŽ-a i njenog osoblja, zastuplja kancelariju u okviru ustanove DT i pred ostalim institucijama u zemlji i inostranstvu; Koordinira rad sa podređenima na realizaciji radnih ciljeva, na osnovu strategije, planova i zakona;

Pobrine se o izradi i sprovođenju politika za KZPŽ, usklađujući unutrašnje procedure u skladu sa važećim zakonima;

Odgovoran za obezbeđivanje prostora i uslova za rad zaposlenih u saradnji sa organizacionom strukturom i kancelarijama DT ustanove;

Učestvuje u organizaciji različitih programa u vezi sa mandatom Kancelarije za Zaštitu i Pomoć Žrtvama;

Savetuje osoblje KZPŽ-a u vezi sa sprovođenjem procedura i projekata u vezi sa Službenicima za Zaštitu Žrtava;

Izveštava u periodima određenim na nivou ustanove DT o radu i dostignućima KZPŽ;

Preduzima sve pravne radnje protiv osoblja KZPŽ-a, na svim nivoima za sprovođenje politike i odgovornosti svakog zaposlenog i za iste je odgovoran.

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Visoke veštine komunikacije, pregovaranja i ubeđivanja u menadžmentu;

Fleksibilan pristup organizaciji i nadzoru rada Kancelarije za rešavanje stručnih i organizacionih problema od značaja za ustanovu;

Detaljna i specijalizovana znanja za izvršenje poslova ZŽ;

Dobro poznavanje rada na kompjuteru sa apliciranjem programa (Microsoft Word, Excel, Power Point itd.);

Veštine komunikacije sa ispravnim pouzdanim i poverljivim ponašanjem;

Veštine za izradu akata i dokumenata i komunikaciju;

Sposobnost određivanja prioriteta za razmatranje predmeta u vezi sa radom ZŽ.;

Da ima obuke iz oblasti ZŽ;

Spremnost za rad sa ljudima različitih nacionalnosti i veroispovesti;

Sposobnost preduzimanja konkretnih inicijativa tokom rada i u vezi sa njim;

Sposobnost održavanja kvaliteta rada iu uslovima rada pod pritiskom ;

Opšte veštine za izveštavanje o postignutim rezultatima rada kao ZŽ, Odgovarajuće reagovanje u rešavanju problema.

Stručna sprema i kvalifikacija :

Univerzitetska Diploma, Pravni Fakultet.

Radno iskustvo:

Najmanje sedam (7) godina profesionalnog radnog iskustva.

Uključujući četiri (4) godine radnog iskustva na rukovodećim pozicijama.

- Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 12.09.2022 do 19.09.2022 kao datum isteka konkursa.
- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Divizionu Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.
- Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učesća na konkursu:
- Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.
- Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od sviju osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.
- „Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova“.
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:
- Svedočanstvo školske spreme;
- Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda i radni ugovor (Referentno pismo ili preporuka se ne prihvataju kao dokaz radnog iskustva).
- Dve preporuke (ako imate);
- Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
- Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
- Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavešteni na osnovu važećeg zakonodavstva.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosovo



MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE AND TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKE I TEHNOLOGIJU

QENDRA E STUDENTËVE
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS
PRISHTINË

STUDENTS' CENTER OF
UNIVERSITY OF PRISHTINA
PRISHTINA

STUDENTSKI CENTAR
UNIVERSITETA PRISHTINE
PRISHTINA

Rruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381 (0) 38/223-951, +381 (0) 38/225-976
Ëeb:qs.rks-gov.net

Qendra e Studentëve në Prishtinë shpallë:

12.09.2022

KONKURS

Për pranimin e studentëve në konvikte dhe ushqim në mensën e studentëve për vitin Akademik 2022/2023.

Aplikimi bëhet përmes sistemit **ONLINE**. Linku për aplikim është i publikuar në web faqen zyrtare të QS-së qs.rks-gov.net dhe në profilin zyrtar në facebook **Qendra e Studenteve-Prishtine**. Udhëzuesi për aplikim gjendet në linkun e shfaqur.

Këtë vit Akademik, studentët e rregullt të UP-së, kanë mundësi të aplikojnë veçmas për të fituar të drejtën për t'u ushqyer në mensën e studentëve.

Kriteret për të aplikuar janë të njëjta sikurse për aplikim për konvikt.

Numri i studentëve që do të përfitojnë për ushqim në mensë, është 1500 student.

Në konviktet dhe mensën e QS-së pranohen studentët e rregullt të studimeve themelore, komuna e të cilëve është 25 km e më larg nga Prishtina.

Kriteret për praninë dhe pikët e mundshme:

1. Studentët nga Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti Teknik dhe Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore me notë mesatare 9.00 dhe me largësi 25 km e më shumë nga Prishtina, pranohen në konvikte pavarësisht totalit të pikëve që fitojnë.
2. Studentët nga fakultetet e tjera me notë mesatare 9.5 dhe me largësi 25 km e më shumë nga Prishtina pranohen në konvikte pavarësisht numrit të pikëve të fituara.
3. Studentët për notë mesatare fitojnë (varësisht nga nota mesatare).....5 - 15 pikë
4. Largësia nga Komuna e Prishtinës.....2 – 10 pikë
5. Studentët jashtë territorit të Republikës për largësi marrin.....15 pikë

Studentët me status të vaçant për pikë shtesë sipas kategorive:

1. student (fëmijë) i dëshmorit -----10 pikë
2. student (fëmijë) i prindit invalid të luftës -----5 pikë
3. student, prindi i të cilit është veteran i luftës -----3 pikë
4. student i të pagjeturit -----5 pikë
5. student invalid civil i luftës -----5 pikë
6. student i prindit martir nga lufta -----4 pikë
7. student me aftësi të kufizuara -----6 pikë
8. student i të burgosurit, politik -----4 pikë
9. student me asistencë sociale -----4 pikë
10. dy e më shumë studentë nga një familje aplikant në QS3 pikë

Të gjithë studentët e këtyre kategorive të cilët përfitojnë pikë shtesë duhet që përmes sistemit ONLINE të ngarkojnë dokumentacionin e kërkuar (vertetimin)nga :

- Shoqata e të Burgosurve Politik, zyra qendrore Prishtinë
- Shoqata e personave me Aftësi të Kufizuara – Hendikos, zyra qendrore Prishtinë.
- Shoqata e familjeve të dëshmorëve – Selia qendrore në Prishtinë

• Studenti i prindit martir nga lufta, student i të pagjeturit, student invalid civil i luftës vendimi i MPMS dhe çertifikata e bashkësisë familjare.

• Studentët , prindërit e të cilëve janë veteran të Luftës , e të cilët marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës, e ngarkojnë çertifikatën e veteranit të prindit , të lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ndërsa studentët prindërit e të cilëve nuk marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës nuk kanë nevojë t'a bëjnë ngarkimin e çertifikatës së prindit veteran, sepse pikët i'u llogariten nga vet sistemi, nga të dhënat e MPMS.

Sqarim: Njoftojmë studentët se pikët e fituara nga nota mesatare, nga largësia, student i prindit invalid të luftës, studentëve me asistencë sociale pikët i'u llogariten përmes sistemit online. Andaj nuk është e nevojshme që këto dokumente të ngarkohen gjatë aplikimit.

. Te kategoria dy e më shumë studentë nga një familje, aplikuesi për vendosje në QS me rastin e aplikimit student i dytë apo i tretë nga e njëjta familje, duhet të shkruaj nr. e letërnjoftimit të aplikantit të parë , në opsionin e hapur për këtë kategori.

• Konkursi mbetet i hapur deri me datën **18.09.2022** nga dita e shpalljes.

• Studentët që kanë thyer Rregulloret në fuqi në Qendrën e Studentëve nuk do të pranohen në konvikte.

• Në konvikte do të pranohen studentët me numrin më të madh të pikëve të fituara.

Publikimi i rezultateve bëhet me datë **26.09.2022** në tabelat e konvikteve dhe faqet zyrtare të QSP.

• Afati për ushtrimin e ankesave **ONLINE** është **27 – 28.09. 2022**.

• Publikimi i rezultateve të ankesave bëhet me datën **03.10.2022**.

Drejtoria e Qendrës së Studentëve, Prishtinë



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosovo



MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE AND TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKE I TEHNOLOGIJU

QENDRA E STUDENTËVE
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS
PRISHTINË

STUDENTS' CENTER OF
UNIVERSITY OF PRISHTINA
PRISHTINA

STUDENTSKI CENTAR
UNIVERSITETA PRISHTINE
PRISHTINA

Rruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381 (0) 38/223-951, +381 (0) 38/225-976
Ëeb:qs.rks-gov.net

Studentski centar u Prištini objavljuje:

12.09.2022

KONKURS

Za prijem studenata u domove i prehranu u studentsku menzu za akademsku godinu 2022/2023.

Prijava se vrši putem ONLINE sustava. Link za prijavu objavljen je na službenoj web stranici QS qs.rks-gov.net i na službenom Facebook profilu Studentski centar-Prishtina. Vodič za prijavu možete pronaći na prikazanoj poveznici.

Ove akademske godine, redovni studenti UP-a imaju mogućnost da se posebno prijave za sticanje prava na ishranu u studentskoj menzi.

Kriterijumi za prijavu na prava hrane su isti kao i za prijavu studentskog doma.

Broj studentia koji će dobiti hranu u menzi je 1500 studenata.

Kriteriji za upis i mogući bodovi:

1. Studenti Medicinskog fakulteta, Tehničkog fakulteta i Fakulteta matematičko-prirodnih znanosti s prosječnom ocjenom 9,00 i udaljenošću od Prištine 25 km i više primaju se u studentske domove bez obzira na ukupan broj bodova.
2. Studenti s drugih fakulteta s prosječnom ocjenom 9,5 i udaljeni 25 km i više od Prištine primaju se u domove bez obzira na broj osvojenih bodova.
3. Učenici za prosječnu ocjenu zarađuju (ovisno o prosječnoj ocjeni)...5 - 15 bodova
4. Udaljenost od općine Priština 2 - 10 bodova
5. Studenti izvan teritorija Republike na udaljenost dobivaju.15 bodova

Studenti sa posebnim statusom za dodatne bodove prema kategorijama:

1. učenik (dijete) mučenika ----- 10 bodova
2. učenik (dijete) ratnog vojnog invalida ----- 5 bodova
3. učenik, čiji je roditelj veteran rata ----- 3 boda
4. učenik nestalog -----5 bodova
5. student invalid civilnog rata -----5 bodova
6. učenik rata mučenik roditelj ----- 4 boda
7. učenik s teškoćama u razvoju ----- 6 bodova
8. zatvorenik student, politički -----4 boda
9. učenik sa socijalnom pomoći -----4 boda
10. dva učenika više iz jedne prijavljene obitelji u QS 3,33 boda

Svi učenici ovih kategorija koji dobiju dodatne bodove moraju putem ONLINE sustava učitati potrebnu dokumentaciju (provjeru) sa:

- Udruženje političkih zatvorenika, sjedište u Prištini
- Udruženje osoba s invaliditetom - Hendikos, sjedište u Prištini.
- Student student student iz rata, student nestalog, student građanskog rata s invaliditetom, odluka MRSZ -a i svjedodžba obiteljske zajednice.

Studenti čiji su roditelji veterani i primaju platu iz Budžeta Republike Kosovo postavljaju uverenje roditelja izdato od strane Vlade Republike Kosova, dok studenti čiji roditelji ne primaju platu iz Budžeta Republike Kosova ne treba učitavati sertifikat roditelja veterana, jer je bodove obračunavano od samog sistema iz podataka Ministarstva prosvete.

Objašnjenje: Objavljavamo učenike da su izračunate bodove dobivene iz prosječne ocjene, s udaljenosti, učenika roditelja mučenika, učenika s ratnim vojnim invalidom, učenika ratnog vojnog invalida, učenika roditelja veterana i učenika s socijalnom pomoći putem mrežnog sustava. Stoga nije potrebno da se ti dokumenti učitavaju tijekom prijave.

U kategoriji dva ili više učenika iz jedne obitelji, podnositelj zahtjeva za smještaj u QS prilikom prijave drugi ili treći student iz iste obitelji, mora napisati ne. osobne iskaznice prvog podnositelja zahtjeva u otvorenoj opciji za ovu kategoriju.

• Natječaj ostaje otvoren do 18.09.2022. Od dana objave.

• Studenti koji su prekršili Pravilnik koji je na snazi u Studentskom centru neće biti primljeni u domove.

• Studenti s najvećim brojem osvojenih bodova bit će primljeni u domove.

Objavlivanje rezultata vrši se **26. 09. 2022.** u tablicama studentskih domova i službenim web stranicama QSP -a.

• Rok za podnošenje **ONLINE** žalbi je **27. - 28.09. 2022.** godine.

• Objavlivanje rezultata pritužbi vrši se **03.10.2022.**

Uprava Studentskog centra, Priština



Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnatia p.n. - 10 000 Prishtinë | www.kuzhina.net | kuzhinaqendrore@gmail.com

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, N.P.L. "Kuzhina Qendrore" SH. A, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

1. TITULLI I PUNËS: PASTRUES/E - DY (2) VEND PUNE

Departamenti: Departamenti i Administratës

Data e njoftimit: 12.09.2022

Afati për aplikim: 12.09.2022– 26.09.2022

Kohëzgjatja: 1 vit

Puna provuese: 6 muaj

I përgjigjet: Udhëheqësit të logjistikës

Nr. i Referencës: 01/22

Detyrat dhe përgjegjësit

- Bën pastrimin e hapësirave, objekteve/mjeteve lëvizëse.
- Është përgjegjës që pastrimi i zyrave, objekteve/mjeteve lëvizëse të bëhet në nivelin më të mirë.
- Mbanë përgjegjësi për nivelin e pastërtisë në zyre, objekte/mjete lëvizëse.
- Bën kërkesën për furnizim të materialit higjienik tek depot e administratës.
- Mbanë evidencë për materialin higjienik, shpenzues dhe është përgjegjës që të kujdeset për shpenzimet e higjienës.
- Kryen detyra tjera të caktuara nga udhëheqësi.
- Për kryerje e detyrave i përgjigjet shefit të logjistikës.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

- Së paku një vit përvojë pune relevante
- Të ketë aftësi të mira komunikimi
- Aftësi të forta të punës në ekip dhe aftësi komunikuese.
- Niveli i lartë i angazhimit dhe orientimi ndaj konsumatorit.
- Aftësitë organizative.
- Besueshmëri.

KUSHTET PËR PJESËMARRJE

Aplikantët e interesuar për këtë vend të punës duhet të bashkëngjisin këto dokumente:

- Aplikacionin e plotësuar.
- CV e aplikantit.
- Dëshminë e kualifikimit shkollor (Kopje).
- Dëshminë mbi përvojën e punës, referencat si dhe certifikata tjera profesionale.
- Dokumentin e identifikimit - letërnjoftimi i fotokopjuar.
- Letër Motivuese për pozitën të cilën aplikoni

2. TITULLI I PUNËS: SHOFER/E - DY (2) VEND PUNE

Departamenti: Departamenti i Administratës

Data e njoftimit: 12.09.2022

Afati për aplikim: 12.09.2022– 26.09.2022

Kohëzgjatja: 1 vit

Puna provuese: 6 muaj

I përgjigjet: Udhëheqësit të Logjistikes

Nr. i Referencës: 02/22

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Shoferi do të ngarkohet me fletë ngarkesë për automjetin –të cilin e drejton.
- Drejton automjetin sipas orarit të përpiluar nga udhëheqësi.
- T'i respektoj standardet e shërbimit të shpërndarjes së shujtave pran çerdheve dhe bizneseve të kontraktuara
- Është përgjegjës për gjendjen teknike dhe paraqitjen e problemeve nga terreni, pastërtinë, furnizimin me karburante dhe lubrifikante.
- Pranon dhe liferon shujtat në të gjitha stacionet e caktuara sipas rendit të shërbimit ndaj klientëve të "Kuzhinës Qendrore" duke respektuar standardet e shërbimit.
- Është i obliguar që para fillimit të orarit të punës të lajmërohet në punë, për të kontrolluar ujën, vajrat, karburantet, sistemin e ajrit dhe defektet – gërvishtjet tjera eventuale në automjet dhe para daljes në vijë të marrë pëlqimin është obligative – fletë urdhëresën dhe fletë dërgesën nga udhëheqësi i sektorit të kuzhinës , se automjeti është i gatshëm të dal në vijë.
- Plotëson urdhëresën e udhëtimit sipas rregullave të përcaktuara nga KQ.
- Nëse konstatohet që nga pakujdesia e shoferit se automjeti ka pasur dëme, atëherë përgjegjësinë do ta bartë vet shoferi.
- Shoferi është përgjegjës në respektimin e rregullave të komunikacionit duke u bazuar në ligj mbi sigurinë në komunikacion, duke u bazuar në automjetin se a është teknikisht në rregull.
- Shoferi mbanë përgjegjësinë nëse konsumon alkool para dhe gjatë vozitjes, nëse konstatohet nga instancat përgjegjëse.
- Shoferi ka për obligim që defektet në automjetin të lajmëroj me kohë me shkrim si dhe të nënshkruan urdhëresën e pranimit të automjetit të riparuar, (nëse nuk urdhërohet që të drejtoj ndonjë automjet tjetër rezervë).
- Shoferi ka të ndaluar pirjen e duhanit dhe alkoolit në automjet
- Nëse për shkaqe shumë të arsyeshme nuk mund të vij në punë, që të mos mbeten dërgesat pa u mbuluar është i obliguar që me kohë ta lajmëroj drejtorin operativ apo dhe të dëshmoj arsyeshmërinë e mos ardhjes në punë.
- Pas përfundimit të orarit të punës është i obliguar të sjell automjetin në bazë dhe të njoftoj zyrtarin e logjistikes për defektet eventuale në autobus , në të kundërtën të nesërmen nëse automjeti nuk del në vijë për shkak të defektit, përgjegjës është shoferi paraparak që se ka lajmëruar defektin.
- Në rast të ndonjë aksidenti, është i obliguar të thërras Policinë, të bëj foto të aksidentit dhe të njoftoj bazën.
- Shoferi e ka të ndaluar të ngasë automjetin në mungesë të ndihmës ose punëtorit teknik.
- Kryen detyra tjera të kërkuara nga përgjegjësi.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

- Patentë/leje të qarkullimit
- Së paku tre vite përvojë pune relevante
- Të ketë aftësi të mira komunikimi
- Aftësi të forta të punës në ekip dhe aftësi komunikuese.
- Niveli i lartë i iniciativës dhe angazhimit.
- Mënyrë e strukturuar, e pavarur dhe e zellshme e punës.
- Niveli i lartë i angazhimit dhe orientimi ndaj konsumatorit.
- Aftësitë organizative.
- Besueshmëri.

KUSHTET PËR PJESËMARRJE

Aplikantët e interesuar për këtë vend të punës duhet të bashkëngjisin këto dokumente:

- Aplikacionin e plotësuar.
- CV e aplikantit.
